REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOAVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr./Br./No 16-21902
Data/Datum/Tarih 06/03/2018
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**
**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE**

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

# VENDIM
## PËR EMRIMIN E KOMISONIT PËR RI VLERSIMIN E OFERTAVE
# Ndërtimi i tregut te Gjelbër mobil, pran Kishës Ortodokse te Gjilanit
**GL 651 18 006 121**

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Muhamet Pajaziti — kryetar i komisionit
2. Saranda Rashiti — anëtare e komisionit
3. Qemajl Selmani — anëtar i komisionit

***Neni 2***

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

***Neni 2.1***

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

***Neni 2.2***

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

***Neni 2.3***

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

***Neni 2.4***

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

***Neni 3***

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë ne rastin e pranimit të këtij vendimi

***Neni 4***

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

***Gjilan 06 /03/2018***

Salih Kqiku
për Ilysof
Drejtor i Departamentit të Prokurimit

Lutfi Haziri
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOAVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr./Br./No. 277
Data/Datum/Tarih 07.03.2018
GJILAN - GNJILANE - GILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL-së; nenit 78.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe në bazë të nenit 11 pika 3 dhe 7 e Ligjit për Teatrot nr.04/L-106, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për**
**Ndryshimin e vendimit për konstituimin e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Gjilanit**

1. Me ndryshohet vendimi për konstituimin e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Gjilanit 02. nr. 17 e dt. 25.01.2016, 02. Nr. 571 e dt. 11.07.2016 dhe 02. nr. 934 i dt. 22.11.2016 dhe në vend të **Shpresa Kurteshit** anëtare e Këshillit emërohet **Shpresa Hajdari**.

2. Me këtë vendim të njoftohen anëtarët e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit.

3. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Vendimi t'i dorëzohet:
anëtarëve të grupit
arkivit

Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN - GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit veteqeverisjes lokale dhe duke u mbështetur nenit 79 pika d) dhe 82.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, kryetari i komunës, merrë këtë :

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr./Br./No. 274
06-03-2018
GJILAN - GNJILANE - GILAN

# V E N D I M

I. Emërohet komisioni për pranim teknik dhe llogarin përfundimtare të punëve të kryera të projektit :

## Asfaltimi i rrugëve ne lagjen "Arbëria"

## GI 651 15 065 521:

Komisioni nga pika I. e këtij vendimi ka këtë përbërje :

1. Shaqir Ukshini — Kryetar i Komisionit
2. Kimete Pavataj Salihu — anëtare e komisionit
3. Sylejman Selishta — anëtar i komisionit

II. Detyrë e komisionit është të kryej pranimin teknik të punimeve të ekzekutuara nga kompania : "TALI **"SH.P.K Gjilan** , në tërësi sipas kontratës për ekzekutimin e punëve dhe të hartojë proqesverbal me shkrim në të cilin do të jepë mendim dhe konstatoj se projketi – objekti në fjalë :

- ✓ I përmbushë - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit apo
- ✓ Nuk i përmbush - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit

III. Gjatë pranimit teknikë janë të obligaur të marin pjesë përfaqësuesit e autorizuar të kryesit të punimeve dhe organi mbukqyrës, të cilët do ti japin informatat e nevojshme lidhur me realizimin e punimeve, komisionit për pranimin teknik të projektit .

IV. Komisioni është i obliguar të përgatis raport me shkrim për punën e vet, i cili duhet t'i prezantohet zyrës së prokurimit dhe zyrës së projekteve.

V. Komisoni është i obliguar që të fillojë punën menjëher pas pranimit të këtij venimi, ndërsa ta përfundoj në afatë prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi .

*Të i dërgohet :*

- *arkivës*
- *zyrës ës prokurimit*
- *zyrës së projekteve*
- *kryesit të punimeve*
- *antarëve të komisonit*
- *mbikqyrsit të punimeve*

05.03.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GNJILANE - Kryetari i Komunës - Predsednik - 2

Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri

Në bazë të nenit 13 të Ligjit veteqeverisjes lokale dhe duke u mbështetur nenit 79 pika d) dhe 82.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, kryetari i komunës, merrë këtë :

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr./Br./No. 273
Data/Datum/Tarih 06.03.2018
GNJILANE - GILAN

# V EN D I M

I. Emërohet komisioni për pranim teknik dhe llogarin përfundimtare të punëve të kryera të projektit :

**Asfaltimi i rrugëve në fshatin Doberqan**
**GI 651 15 068 521**:

Komisioni nga pika I. e këtij vendimi ka këtë përbërje :

1. Fadil Sherifi — Kryetar i Komisionit
2. Shaqir Ukshini — anëtar i komisionit
3. Izet Kurteshi — anëtar i komisionit

II. Detyrë e komisionit është të kryej pranimin teknik të punimeve të ekzekutuara nga kompania : "TALI "**SH.P.K Gjilan** , në tërësi sipas kontratës për ekzekutimin e punëve dhe të hartojë proqesverbal me shkrim në të cilin do të jepë mendim dhe konstatoj se projketi – objekti në fjalë :

- ✓ I përmbushë - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit apo
- ✓ Nuk i përmbush - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit

III. Gjatë pranimit teknikë janë të obligaur të marin pjesë përfaqësuesit e autorizuar të kryesit të punimeve dhe organi mbukqyrës, të cilët do ti japin informatat e nevojshme lidhur me realizimin e punimeve, komisionit për pranimin teknik të projektit .

IV. Komisioni është i obliguar të përgatis raport me shkrim për punën e vet, i cili duhet t'i prezantohet zyrës së prokurimit dhe zyrës së projekteve.

V. Komisoni është i obliguar që të filloje punën menjëher pas pranimit të këtij venimi, ndërsa ta përfundoj në afatë prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi .

*Të i dërgohet :*

- *arkivës*
- *zyrës ës prokurimit*
- *zyrës së projekteve*
- *kryesit të punimeve*
- *antarëve të komisonit*
- *mbikqyrsit të punimeve*

05.03.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GNJILANE - Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine - 2

Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr/Br/No 271
Data/Datum/Tarih 05 03 2018

**ZYRA E KRYETARIT**
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kryetari i Komunës në zbatim të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, nxjerrë:

# V E N D I M
# PËR PAGESAT TJERA NË RRETHANA TË VEÇANTA

**I**

Nëpunësja civile, z. Bahri Uka i caktuar në detyra punuese **Arkivist** në kuadër të Drejtorisë për buxhet dhe financa, **I lejohet** ndihma monetare në lartësi të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil komunal, në shumën prej 369 € për shkak të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (nënës), Vahide Uka me datë **21.02.2018**.

**II**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Certifikata nga libri amzë i të vdekurve nr. i referencës **4/2018RV/4001 e datës 28.02.2018**, lëshuar nga Shërbimi i gjendjes civile në DAP- Gjilan.

**III**

Pagesa duhet bërë nga kodi buxhetor Subvencione ose Mallra dhe shërbime i DBF në xhirollogarinë rrjedhëse të shërbyesit civil e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**
-Drejtorit të DBF
-Shërbyesit civil
-Në dosje

**Kryetari i Komunës**

**Lutfi Haziri**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr/Br/No. 270
Data/Datum/Tarih 05.03.2018

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E GJILANIT**
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

---

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA – MAYOR'S OFFICE – BSAKAN OFISI**

---

Në bazë të nenit 13 të LVL-së dhe nenit 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit, kryetari i Komunës merr këtë :

# VENDIM
## PËR PAGESËN E RESUSEV NJERZORE NË KUADËR TË "FLAKËS SË JANRIT" PËR FESTIVALIN E DRAMËS KOMBËTARE " TALIJA E FLAKËS "

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e resurseve njerzore për shfaqjen "Një natë në Hotel " pjesmarës në Festivalin e Dramës Kombëtare "Talija e Flakës" në kuadër të manifestimit multikulturorë "Flaka e Janarit " 2018 si në vijim :

| | | | |
|---|---|---|---|
| Autorsija | 500.00 | Fatime Shahiqi | 1150000941929968 |
| Regjisori | 3.000.00 | Bashkim Ramadani | 1960293348321180 |
| Dramaturgu | 750.00 | Agush Mulliqi | 2011000142544450 |
| Skenografi | 750.00 | Burim Arifi | 1110281390000174 |
| Kostimografi /ja | 750.00 | Valdete Mustafa | 1903533511321169 |
| Grim,Parikuer | 250.00 | Minivere Fejzullahu | 1960473380321180 |
| Robaqepsja | 250.00 | Albana Sadriu | 1702010401055733 |
| Përzgjedh efek. muzikore | 300.00 | Florim Gagica | 1302271100214666 |
| Pregaditje Grafike | 300.00 | Bekim Korqa | 1150124672000166 |
| **T O T A L I** | **6.850.00** | | |

Kompenzimi material të bëhet nga mjetet qeveritare të ndara për mbulimin e shpenzimeve për manifestimin multikulturorë "Flaka e Janarit " 2018 sipas vendimit qeveritarë Nr.06/24 në vlerë prej 54.850.00 eur. të transveruara në Komunën e Gjilanit në programin Kulturë,Rini dhe Sport të nën programit 10/651/85027/20/00000/0820 në kategorin e shpenzimeve subvencioneve dhe transvereve me Nr.06/41-1 të datës 17.01.2018.

Ky vendim hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit nga kryetari Komunës së Gjilanit

Gjilan 08.01.2018

Lutfi Haziri
Kryetarë i Komunës

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E GJILANIT**
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr. 269
Datum/Tarih 05.03.2018

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE**

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr.03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe në zbatim të nenit 3 të kontratës për shërbime,Kryetari i Komunës së Gjilanit,merr këtë:

## VENDIM

## PËR EMËRIMIN E GRUPIT PUNUES PËR PËRCJELLJEN E PUNËS SË HARTUSIT TË OBJEKTIT TEGTAR "TREGU I GJELBËRT NË QYTETIN E GJILANIT"

1.Më këtë vendim emërohet Grupi Punues në këtë përbërje:

1.1 Udhëheqësi nga Drejtoria Zhvillimit Ekonomik Kryesues

| | |
|---|---|
| 1. 2 Një ida.Anëtar | Eroll Jonuzi |
| 1.3 Një idn-Konstruktiv,Anëtar | Ridvan Aliu |
| 1.4 Një idn-Hidro,Anëtar | Edon Shkodra |
| 1.5 Një ide,Anëtar | Mejdi Ahmeti |
| 1.6 Një idm,Anëtar | Herolind Bajraliu |
| 1.7 Një inxhinier i Xheodezisë | Gëzime Hajdari |

2. Grupi punues bënë monitorimin e hartimit të projekteve kryesore (arkitekturë,statikë,ujësjellës dhe kanalizim,ngrohje qendrore-ventilim etj)duke pasur për bazë projektin ideor dhe dokumentacionin e caktuar që ishte pjesë e konkursit të projektimit.

3. Kujdeset që hartuesi i projektit gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatoj rregullativën aktuale ligjore që ka të bëjë me hartimin e dokumentacionit teknik.

4. Pranon nga autoriteti kontraktues dokumentacionin (në formë elektronike) të kontraktuesit të përgjedhur.

5. kryesuesi i Grupit punues,pranon nga hartuesi i projektit (kompania) planin dinamik pas 5 ditë pune pas nënshkrimit të kontratës ashtu siç është përcaktuar në nenin 5 të kontratës, të specifikuar me aktivitete duke pasur për bazë aftin për përmbylljen e projektit që është 30 ditë pune.

6. Aprovon zgjidhjen e ofruar nga kontraktuesi sipas fazave përkatëse në funksion të hartimit të projektit kryesor.

**Vendimi i dorëzohet:**

**-DBF-së**

**-Anëtarëve**

**-Arkivi**

**Lutfi Haziri**
**Kryetar i Komunës së Gjilanit**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr./Br./No. 268
Date/Datum/Tarih 05.03.2018
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014 dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit nr. 01. Nr. 16-18522 të dt. 22.02.2018 për caktimin e lokacionit për nevojat e ndërtimit të fushave sintetike të futbollit sipas standardeve të FIFA –së dhe UEFA-së , Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

**VENDIM**
**PËR**
**MENAXHIM ME FUSHAT SINTETIKE TË FUTBOLLIT**

1. Me këtë vendim përcaktohet menaxhimi me fushat sintetike të futbollit:

   1.1. njëra në ngastrat kadastrale: 1648-4 dhe 1886-2 me sipërfaqe te përgjithshme prej 11733m$^2$ zona kadastrale Gjilan në "Zabel të Sahit Agës" për nevoja të **S.C "Gjilani"** nga Gjilani dhe

   1.2. Parcela kadastrale 120-3 me sipërfaqe prej 15736m$^2$ vendi i quajtur "Gllama" zona kadastrale Livoç i Epërm për nevoja të **F.C "Drita"** nga Gjilani.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi me këto fusha sintetike të futbollit do të menaxhojë Njësia për Kulturë Rini e Sport gjegjësisht sektori i sportit në kuadër të komunës së Gjilanit.

3. Pjesë e këtij vendimi është edhe vendimi i Kuvendit të komunës së Gjilanit 01. nr. 16-18522 të dt. 22.02.2018 për Caktimin e Lokacionit për Nevojat e Ndërtimit të Fushave Sintetike të Futbollit sipas Standardeve të FIFA-së dhe UEFA-së.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Kryetari i Komunës**

**Lutfi Haziri**

**Me këtë vendim të njoftohen**:
-Federata e Futbollit të Kosovës,
- NJKRS.
- Arkiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL, nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës të Gjilanit, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës në zbatim të nenit 90 paragrafi 2 nënparag. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr këtë:

## V E N D I M
## PËR
## PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

**1.** Nëpunësit civil, **z. Nijazi Shabani** i lindur më: **09.03.1953**, i caktuar në detyra të punës, **Zyrtar i arsimit fillor** në kuadër të **Drejtorisë për Arsim** i **Përfundon** punësimi në Shërbimin Civil Komunal më: **09.03.2018** sipas fuqisë së ligjit - **Pensionimi.**
**2.** Nëpunësit civil të pensionuar i takon e drejta e një page shtesë për pensionim në shumë prej një page mujore të njëhershme në vlerë të pagës së fundit para pensionimit.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, **z Nijazi Shabani** i caktuar në detyra punuese **Zyrtar i arsimit fillor** në kuadër të **Drejtorisë për Arsim** ka arritur moshën **65** vjeçare, moshën e pensionit më datë; **09.03.2018** dhe sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është caktuar shkuarja në pensionin e merituar me të drejtën e pagesës së një page shtesë për shkak të pensionimit.
Organi i punësimit, pas shqyrtimit të shkresave në dosjen personale të të punësuarit, konstatoi se; nëpunësi civil ka arritur moshën e pensionimit, andaj në bazë të nenit 90 paragrafi 2 nënparagrafi. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil dhe nenin 19 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të tjera të Nëpunësve Civil, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë komisionit të ankesave, brenda autoritetit komunal në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

**VENDIMI T`I DORËZOHET:**
- **DA**
- **Nëpunësit civil**
- **Njësisë së personelit**

**Kryetari i Komunës**

**Lutfi Haziri**